


# Prezenca Austro-Hungareze në Shqipëri

arkitekturë, planifikim, infrastrukturë

1916 - 1935



## Hyrje

Ky botim vjen në trajtën e një studimi në kuadrin e serie publikimesh mbi ndikimin e kulturave të ndryshme projektuese në Shqipëri, duke evidentuar ndikimin perandorisë Austro-Hungareze në zhvillimin e vendit në fillim të shekullit të 20-të. Punimi u realizua në kuadrin e një projekti bashkëpunimi midis Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU) të Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT) dhe Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit (AQTN).

Me anë të këtij kërkimi, hidhet dritë mbi influencën e Austro-Hungarisë në periudhën mbas pavarësisë së Shqipërisë, në vitet 1916-1935, para ndikimit të fortë italian në shoqërinë shqiptare, jo vetëm për të evidentuar projektet e realizuara në atë kohë, por dhe për të prezantuar kontributin e dhënë në periudhën e formimit të identitetit të shtetit shqiptar.

Botimi evidenton disa prej projekteve më të shquara të inxhinierëve dhe specialistëve austro-hungarez në fushën e planifikimit urban, të arkitekturës dhe veprave të artit në infrastrukturë, duke u bazuar në dokumentet e mundësuar nga fondi i AQTN-së dhe nga hulumtimi i botimeve të ndryshme që trajtojnë këtë periudhë.



2. Pamje ajrore e pazarit të Tiranës vitet '20, para ndërrhyrjeve



Gjatë shekullit të XIX qyteti i Tiranës mori pamjen e një qyteti tregtar duke u nisur nga kërkesat ekonomike të zonës, duke paraqitur shembullin e kalimit nga një qëndër e vogël e banuar, drejt një qyteti të mirëfilltë. Për këtë kontribuan veçanërisht familjet e pasura të qytetit.

Qyteti shtrihej rreth qendrës së tij, ku ishte ndërtuar pazari dhe dy xhamitë më të shquara. Arteriet rrugore në formë radiale, lidhnin qendrën e qytetit me lagjet e banuara. Struktura e çrregullt urbane e Tiranës ishte kryesisht produkt i rendit feudal, i prapambetjes ekonomike. Në të bënë pjesë dy zona, ajo e banimit dhe ajo tregëtare.

Banesat tipike të Tiranës ishin kryesisht një ose dykatëshe të ndërtuara me qerpiç dhe të rrethuara me mure të ulëta. Zona tregtare përfaqësohej nga pazari i vendosur në pjesën qendrore të qytetit. Pazari i vjetër i cili ishte i përbërë prej dyqanesh me galeri e strehë druri, u rindërtua në vitin 1905 sipas Degrand<sup>1</sup>-it.

Të dy këto zona kryqëzohen ndërmjet tyre me rrugë të ndryshme si për qerre, për karvan e për këmbësore, të cilat më vonë u kthyen në rrugë për automjete. Deri në shek. XX Tirana ishte formuar dhe zhvilluar pa asnjë plan urban, si nga ana formale po ashtu dhe legjislativë. Struktura e trashëguar e pëlhurës urbane kishte tipare Osmane-orientale ku qyteti përbëhej nga pazari, objektet e kultit dhe banesat. Pazari ishte qendra ekonomiko sociale e qytetit, ku të gjitha shërbimet organizoheshin aty.

<sup>1</sup>Degrand, A. (1901). *Souvenirs de la Haute Albanie*, Paris, 1901

Ndërhyrja e parë e planifikuar në qytet u bë më 1908-të nga Esad Pashë Toptani<sup>2</sup>. Projekti hapi dhe modernizoi pazarin, duke zgjeruar rrugët dhe riorganizuar dyqanet me një ansambël peristil. Plani i Toptanit ishte ambicioz për Tiranën orientale. Duhej të kalonin edhe 8 vite që Tirana të rilevohej për herë të parë në 1916 nga Instituti Ushtarak i Gjeografise (Zentrum Militärischen Präsenz) i Perandorisë Austro-Hungareze. Në vitet 1917-të dhe 1918-të janë dokumentuar nga specialistët hartat e para të cilat do hidhnin gurin e themelit të transformimit që pritej të ndodhnin në Tiranë. Gjatë kësaj periudhe, brenda katër viteve, inxhinierët dhe specialistët nga perandoria Austro-Hungareze projektuan dhe ndërtuan më shumë se 900 km rrugë<sup>3</sup>. Ata krijuan institucione që për herë të parë në Shqipëri formuan një kornizë ligjore mbi ndërtimtarinë. Në vitin 1913, ndërtesa e parë e projektuar nga inxhinieret dhe specialistët Austro-Hungarez në Tiranë<sup>4</sup> (Ish shtëpia e Oficerëve, e cila u kthye në Parlamentin e Shqipërisë në vitet 1924 -1928) do përcaktonte qendrën e Tiranës që do quhej më vonë "Sheshi Skanderbeg".

Më 1920 Tirana shpallet kryeqytet dhe infrastruktura, ndërtesat për qeverinë, ministritë, gjykatat nuk ekzistonin, madje edhe varrezat ishin akoma në zemër të qytetit. Qyteti kishte një sipërfaqe prej 305 ha me 15000 banorë. Pas një viti, në 1921, popullsia pësoi rritje prej 15% drejt veri-perëndimit dhe jug-perëndimit. Kështu u pa e domosdoshme hartimi i një plani rregullues për Tiranën që do ta transformonte atë në një qytet perëndimor.



<sup>2</sup> Aliqi, B., Lulo, K., Myftiu, G. (2003). *Tirana-sfida e zhvillimit urban*, Co-Plan & SEDA, Tirane, 2003.


<sup>3</sup> Stiller, A. (2010). *Tirana. Planen, Bauen, Leben. Architektur im Ringtum XXII*. Mury Salzmann Verlag, Salsburg-Wien, Austria, 2010.

<sup>4</sup> Baratin, L., Aciemo, M., Muratore, O. (2012). *Instruments and Methodologies for Cultural Heritage Coservation and Valorization*, Gabbiano Editoria Comunicazione, Ancona, 2012, f. 232.

# STADTPLAN von TIRANA

Ausgeführt von der  
K.U.K. KRIEGSMAPPINGSABTEILUNG N° 7  
unt. Leitung des Abt. Komdt. Hptm.v. MILIUS

April 1917



3. Plani i parë i Tiranës, 1917

